




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES

SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA  
KOMANDA MBËSHTETËSE



Nr. 148/2 Prot.

Tiranë, më 07.07. 2026

**Lënda:** Kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve për transportin e materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 09 nëntor 2025.

**KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Tiranë**

Komanda Mbështetëse, në zbatim të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 2407, datë 06.11.2025 "Për vënie mjetesh në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për transportin e materialeve zgjedhore", në periudhat kohore 30 tetor 2025 deri 07 nëntor 2025, ka mbështetur Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, me 21 kamionë transporti (kamion të mbuluar) për transportin e materialeve zgjedhore nga magazinat e KQZ, Lundër, Tiranë për në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjidhor në pesë bashki Vlorë, Berat, Tepelenë, Cërrik dhe Mat.

Për realizimin e detyrës nga Komanda Mbështetëse (sipas përlllogaritjeve të bëra të krahasuara dhe me GPS e mjeteve) për periudhën 31 tetor deri më 07 nëntor 2025, janë aktivizuar 21 kamionë transporti (kamion të mbuluar) të cilat në total kanë harxhuar një sasi prej **1 625 litra gazoil** me vlerë **289,835 lekë**, sasi prej **35 litra vaj lubrifikant** me vlerë **10 920 lekë**, dhe janë angazhuar 35 personel që trajtohen me dietë jashtë rrethit me vlerë **192 500 lekë**.

Vlera totale e shpenzimeve për transportimin e materialeve zgjedhore është **493, 255 lekë**, e cila duhet të rimbursohet nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve bazuar në akt-rakordimin e bërë ndërmjet dy palëve (Komanda Mbështetëse dhe KQZ).

Për rimbursimin e karburantit të konsumuar ju jemi drejtuar:

- me shkresën nr. 1763/4, datë 14.11.2025 "Kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve për transportin e materialeve zgjedhore dhe,
- me shkresën nr. 207/1, datë 14.01.2026 "Ridërgim dokumentacioni për plotësimin e praktikave për rimbursimin e shpenzimeve për transportin e materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 09 nëntor 2025", por nuk kemi marrë përgjigje nga institucioni Juaj.

Për sa më sipër, lutemi të kryeni rimbursimin e shpenzimeve të bëra nga Komanda Mbështetëse në përputhje me konfirmimin e bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe/ose Komisioni Zonal i Administrimit Zgjidhor, të sasisë së karburantit që është harxhuar për realizimin e transportit të materialeve **zgjedhore prej 1, 625 (njëmijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) litra**.

Bashkëlidhur, shkresa me nr. 1763/4, datë 14.11.2025 dhe shkresa nr. 207/1, datë 14.01.2026.

**Ju faleminderit për bashkëpunimin.**

**KOMANDANTI**

**Gjeneral brigade Aleksandër Pando**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA  
KOMANDA MBËSHTETËSE

Nr. 1763/4 Prot.

Tiranë, më 14.11.2025

**Lënda:** Kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve për transportin e materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 09 nëntor 2025.

**KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Tiranë**

Komanda Mbështetëse, në zbatim të urdhrimit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 2407, datë 06.11.2025 "Për vënie mjetesh në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për transportin e materialeve zgjedhore", në periudhat kohore 30 tetor 2025 deri 7 nëntor 2025, ka mbështetur Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, me 21 kamionë transporti (kamion të mbuluar) për transportin e materialeve zgjedhore nga magazinat e KQZ, Lundër, Tiranë për në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjidhor në pesë bashki Vlorë, Berat, Tepelenë, Cërrik dhe Mat.

Nga Komanda Mbështetëse (Batalioni i Transportit), është bërë mbështetja me mjete transporti për transportin e materialeve zgjedhore nëpër qarqe dhe rrethe, si më poshtë;

• Faza e parë.

- Në datën 31.10.2025, u angazhuan në detyrë, 2 (dy) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore për në bashkinë Vlorë.
- Në datën 31.10.2025, u angazhuan në detyrë, 2 (dy) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore për në bashkinë Berat.
- Në datën 31.10.2025, u angazhuan në detyrë, 1 (një) automjet transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore për në bashkinë Tepelenë.
- Në datën 31.10.2025, u angazhuan në detyrë, 1 (një) automjet transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore për në bashkinë Cërrik.
- Në datën 31.10.2025, u angazhuan në detyrë, 1 (një) automjet transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore. Për në bashkinë Burrel.
- Në datën 31.11.2025, për kontrollin e mjeteve të angazhuara në dispozicionin të KQZ mjeti Toyota me targë MM 201 KM.

• Faza e dytë.

- Në datën 7.11.2025, u angazhuan në detyrë, 5 (pesë) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore për në bashkinë Vlorë.
- Në datën 7.11.2025, u angazhuan në detyrë, 3 (tre) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore për në bashkinë Berat.
- Në datën 7.11.2025, u angazhuan në detyrë, 2 (dy) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore, për në bashkinë Cërrik.
- Në datën 7.11.2025, u angazhuan në detyrë, 2 (dy) automjete transporti të cilat bënë transportimin e materialeve zgjedhore për në bashkinë Burrel.
- Në datën 7.11.2025, për kontrollin e mjeteve të angazhuara në dispozicionin të KQZ mjeti Toyota me targë MM 201 KM.

I gjithë procesi i transportimit të materialeve zgjedhore është mbikqyrur dhe ndjekur nga përfaqësues të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Për realizimin e detyrës nga Komanda Mbështetëse (sipas përlogaritjeve të bëra të krahasuara dhe me GPS e mjeteve) për periudhën 31 tetor deri më 7 nëntor 2025 janë aktivizuar 21 kamionë transporti (kamion të mbuluar) të cilat në total kanë harxhuar një sasi prej **1 625 litra gazoil** me vlerë **289,835 lekë**, sasi prej **35 litra vaj lubrifikant** me vlerë **10 920 lekë**, dhe janë angazhuar 35 personel që trajtohen me dietë jashtë rrethit me vlerë **192 500 lekë**.

Vlera totale e shpenzimeve për transportimin e materialeve zgjedhore është **493, 255 lekë**, e cila duhet të rimburohet nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve bazuar në akt-rakordimin e bërë ndërmjet dy palëve (Komanda Mbështetëse dhe KQZ).

Për sa më sipër, bazuar në pikën 2 të akt marrëveshjeve (të mëparëshme) së lidhur ndërmjet palëve, është detyrim i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, të rimburojë shpenzimet direkte (vajra lubrifikante, dieta dhe shpenzime të tjera për personelin e angazhuar), sipas argumentimit të shpenzimeve të bërë nga Komanda Mbështetëse në përputhje me konfirmimin e bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe/ose Komisioni Zonal i Administrimit Zgjidhor, të rimburohet në natyrë sasinë e karburantit që është harxhuar për realizimin e transportit të materialeve **zgjedhore prej 1, 625 (njëmijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) litra, dhe vlerë, konsumin e vajrave lubrifikante 10 920 lekë, si dhe shpenzime për personelin, 192 500 lekë**.

Bashkëlidhur,

- Tabela me zërat e shpenzime e përlogafitur nga Komanda Mbështetëse.

*Ju faleminderit për bashkëpunimin.*

**KOMANDANTI**

**Gjeneral brigade Aleksandër Pando**

Në mungesë dhe me urdhër

**ZËVENDËSKOMANDANTI**


Kolonel Shkëlqim Qela



**KOSTO PERFUNDIMTARE E SHPENZIMEVE FINANCIARE  
PER TRANSPORTIMIN E MATERIALEVE ZGJEDHORE**

Nr.	Emertimi i materialit	Njesia	Cmimi per njesi me TVSH	Sasia	Vlera ne total (lekë)
1	2	3	4	5	6
<b>I</b>	<b>Shpenzime Transporti</b>				<b>300,170</b>
1	Gazoil	Litra	178	1,625	289,250
2	Benzine	Litra	0	0	0
3	Vaj SAE 20*50	Litra	0	0	0
4	Vaj 15*40	Litra	312	35	10,920
<b>II</b>	<b>Shpenzime Personeli</b>				<b>0</b>
1	Personel trajtuar me ushqim	Ditë	0	0	0
2	Personel me diete	Ditë	0	0	0
5	Ore pune jashte orarit	Ditë	0	0	0
6	Shpenzime udhetimi	Ditë	0	0	0
<b>III</b>	<b>Amortizimi mjetesh</b>		0	0	0
	<b>TOTALI</b>	*			<b>300,170</b>

Shefi i Logjistikës  
N/Kolonel Zydi Acani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA  
KOMANDA MBËSHTETËSE

Nr. 207 Prot.

Tiranë, më 14. 01. 2026

**Lënda:** Ridërgim dokumentacioni për plotësimin e praktikave për rimbursimin e shpenzimeve për transportin e materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 09 nëntor 2025.

**KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Tiranë**

Komanda Mbështetëse, në zbatim të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 2407, datë 06.11.2025 “Për vënie mjetesh në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për transportin e materialeve zgjedhore”, në periudhat kohore 30 tetor 2025 deri 7 nëntor 2025, ka mbështetur Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, me 21 kamionë transporti (kamion të mbuluar) për transportin e materialeve zgjedhore nga magazinat e KQZ, Lundër, Tiranë për në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor në pesë bashki Vlorë, Berat, Tepelenë, Cërrik dhe Mat.

Komanda Mbështetëse me shkresën nr. 1763/4, datë 14.11.2025 “Kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve për transportin e materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 09 nëntor 2025”, bazuar në pikën 2 të akt marrëveshjeve (të mëparëshme) të lidhur ndërmjet palëve, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për rimbursimin e shpenzimeve direkte (vajra lubrifikante, dieta dhe shpenzime të tjera për personelin e angazhuar), sipas argumentimit të shpenzimeve të bërë, në përputhje me konfirmimin e bërë nga KQZ dhe/ose KZAZ.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk na janë rimbursuar shpenzimet, pasi është kërkuar bashkëlidhur dokumentacion shtesë, që tregon angazhimin e mjeteve, personelin, kilometrat e përshkruara dhe karburantin e harxhuar.

*Për plotësimin e detyrimeve më KQZ, bashkëlidhur Ju dërgojmë fletët e udhëtimit të veçuara (ndara) më vete dhe të nënshkruar nga përfaqësuesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose/dhe Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor.*

Bashkëlidhur;

- Shkresa me nr. 1763/4, datë 14.11.2025 “Kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve për transportin e materialeve zgjedhore;
- fletët e udhëtimit që vërtetojnë përshkrimin e kilometrave të nënshkruara nga KQZ/KZAZ dhe konsumin e karburantit sipas normës së harxhimit.

*Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.*

**KOMANDANTI**

**Gjeneral brigade Aleksandër Pando**

